

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË SHTYPSHKRONJËN E LETRAVE ME VLERË ME OBJEKT "ZBATIMI I LIGJSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË EKONOMIKO-FINANCIARE" PËR PERIUDHËN 01.01.2013 – 31.12.2014.

Raporti Përfundimtar i Auditimit i ushtruar në Shtypshkronjën e Letrave me Vlerë, me objekt "Zbatimi i Ligjshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare", për periudhën 01.01.2013 deri në 31.12.2014, si dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH-së Nr. 122, datë 21.09.2015. Bazuar në nenet 15, 25, 30 dhe 32 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për përmirësimin e gjendjes, me shkresën nr. 1120/11, datë 20.06.2015, Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet përkatëse i janë dërguar z. N. T. Drejtor i Shtypshkronjës së Letrave me Vlerë, ku janë rekomanduar dhe kërkuar zbatimi i masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

Marrëdhëniet e punës në subjektin Shtypshkronja e Letrave me Vlerë sha për vitin 2013 janë rregulluar përmes marrëveshjes kolektive të punës të nënshkruar më datë 03.04.2012 ndërmjet punëdhënësit S.SH dhe punëmarrësve të Sindikatës së Pavarur, Kjo kontratë në nenin 3 të saj përcakton se: *"....siguron mbajtjen në punë të të gjithë punonjësve të Shtypshkronjës me përjashtim të rasteve kur parashikohen nga Kodi i Punës për shkelje të disiplinës në punë. "* Me ndryshimin e administratorit të shoqërisë, konstatojmë se *largimet nga puna janë kryer pa përfunduar kontratën dhe pa dokumentuar ndonjë thyerje disiplinore në punë nga ana e punëmarrësve.* Largimet e dymbëdhjetë punonjësve nga puna kanë qenë të pajustificuara, pasi njoftimi për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës ka qenë i menjëhershëm dhe nuk është zbatuar afati kohor i përcaktuar në Kodin e Punës. Gjithashtu konstatohet që këto mangësi janë shoqëruar nga praktika punësimi *jo transparente dhe të hapura pasi nuk konstatojmë asnjë shpallje për punësim në zyrën e punës apo në median e shkruar, dhe për më tepër nuk kishte asnjë kriter punësimi të përcaktuar. Në 5 raste edhe pse marrëdhëniet juridike të punonjësve janë ndërprerë me urdhër të administratorit, ata kanë vazhduar zëvendësimin e kolegëve me leje, dhe më pas kanë përfunduar lejen e tyre vjetore në një kohë që marrëdhëniet e punës kanë qenë të përfunduara.*

Për këtë është rekomanduar:

Nga ana e Administratorit dhe Këshillit Mbikëqyrës të merren masa të menjëhershme për të rishikuar rregulloren sidomos pjesën e marrëdhënieve të punës. Të përcaktohen rregulla të qarta për procedurat e punësimit, kriteret e punësimit, kohën e provës dhe mbarëvajtjen e proceseve të punës gjatë kohës së lejes së zakonshme. Të sanksionohet qartë transparenca lidhur me shpalljen e vendeve të lira të punës dhe procedurat e punësimit, ndërkohe që inkurajojmë bashkëpunimin me zyrën e punës për plotësimin e vendeve të lira, sidomos për punonjësit me arsim profesional.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

2. Nga auditimi mbi hartimin e miratimit të projektprogramit të zhvillimit ekonomik për vitet 2013 dhe 2014 konstatohet se, këto projektprograme shpenzimesh si për vitin 2013 dhe për vitin 2014 nuk janë hartuar dhe mbështetur në tregues reale, por janë plotësuar në mënyrë formale. Për të qenë të kujdesshëm e cilësojmë këtë fakt që krijon hapësira për shpenzime të pajustificuara gjatë zbatimit të këtyre programeve, si për shembull zëri "Lyerje" është planifikuar/realizuar çdo vit pavarësisht se nga kontrolli në subjekt nuk

verifikohet një mirëmbajtje vjetore e mureve të ndërtesës ku zhvillohet aktiviteti, Gjithashtu konstatohet shpenzimi për licencë mjedisore ndërkohë që dihet që një shpenzim i tillë është kusht në fillim të aktivitetit. Ajo që konsiderohet akoma më me rëndësi është se i kanë lenë hapësirë administrimit që të realizojë blerje të pajustificuara dhe përdorim jo eficient të fondeve në dispozicion sidomos në shpenzimet për blerje lënde të parë (letër) duke krijuar një stok të pajustificueshëm dhe në nivele të tilla inventarësh sa nevojat vjetore të këtij materiali. U konstatua se për periudhën objekt auditimi nga administratorët nuk janë marrë në analizë tremujore realizimi i treguesve ekonomikë të shoqërisë, kjo për të parandaluar risqet dhe rishikuar treguesit të cilët nuk ishin marrë në konsideratë në kohën e programimit të treguesve. **Për këtë është rekomanduar:**

-Nga Administratori të merren masa për hartimin dhe paraqitjen për miratim në Këshillin e Administrimit dhe më pas në Ministri, të treguesve e programeve të zhvillimit ekonomik, të shoqëruara këto me shpjegime të hollësishme për domosdoshmërinë e secilit prej tyre, duke eliminuar rastet e vendimmarrjeve formale të konstatuara gjatë këtij auditimi

-Vlerësimin e treguesve ekonomik çdo tre muaj të jetë në qendër të vëmendjes së Këshillit të Administrimit sidomos pas konstatimeve që aktiviteti nuk ka qenë në eficiencën e kërkuar dhe duke mbajtur parasysh që duhet të rritet roli strategjik i kësaj shoqërie në vijimësi.

Vazhdimisht

3. Nga auditimi i elementëve të kostos së produktit të shoqërisë për vitet 2013 dhe 2014 kemi evidentuar se: në zërin shpenzime për pagat, punonjësit e shtypshkronjës përfitojnë në formën e suplementit ushqimor shtesën prej 500 lekë, jo vetëm punonjësit që kanë kontakt me lëndët kimike por edhe punonjësit e tjerë të administratës që nuk kanë kontakt me lëndët kimike, duke rritur në mënyrë të padrejtë shpenzimet dhe koston për njësi. Në lidhje me këtë çështje, ndonëse ka një vendim të Këshillit të Administrimit nr. 76/1, 09.04.2009, i cili vendos miratimin e shtesës së kuotës ushqimore nga 450 lekë në 500 lekë për ditë pune, por nuk ka një analizë të nivelit të kontaktit sipas pozicioneve dhe funksioneve brenda shoqërisë, kjo ka bërë që trajtimi të jetë i njëjtë dhe i pa konfirmuar nga inspektorati shtetëror i punës i cili është institucioni i vetëm që përcakton jo vetëm nivelin e kontaktit me lëndë kimike por nga ana tjetër edhe masën e suplementit ushqimor të duhur. Ndërsa në zërin shpenzime për lëndën e parë (letër për shtypshkrime), konstatohet se nevojat për njësi prodhimi janë rritur në mënyrë artificiale, kështu për prodhimin e 1,000 copë "Blloqe - Fatura të modelit me TVSH", sasia e letrës në kartën teknologjike është parashikuar më tepër për 18 kg duke sjellë si pasojë rritjen artificiale të kostos për njësi. Në këto kushte nga llogaritjet tona del se vetëm për prodhimin e 20,000 copë blloqe humbja arrin në rreth 2,000 copë blloqe.

Për këtë është rekomanduar:

-Nga Administratori të merren masa për vlerësimin e nivelit të ekspozimit ndaj lëndëve kimike të çdo pozicioni nga inspektorati shtetëror dhe të përcaktohet në bashkëpunim me ta nivelin e suplementit ushqimor, duke e bërë më pas këtë vendimmarrje pjesë të rregullore (pjesa e marrëdhënieve të punësimit) të shoqërisë.

-Këshilli Administrativ të ngrëjë grup të veçantë pune, me pjesëmarrjen e specialistëve të prodhimit dhe të financës për të përcaktuar në mënyrë të hollësishme zërat e kostos për çdo prodhim dhe sipas kartave teknologjike respektive.

Menjëherë

4. Me transformimin e Shtypshkronjës së Letrave me Vlerë nga ndërmarrje shtetërore në shoqëri aksionere në vitin 2008, ajo është drejtuar nga Këshilla Administrimi me pesë

anëtarë të zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme (Ministri i Financave). Duke u nisur nga treguesit ekonomik-financiar të këtij institucioni, faktit që funksionet e Këshillit të Administrimit janë realizuar formalisht si dhe faktit që deri në fund të vitit 2013, kjo shoqëri e kishte humbur statusin e shoqërisë me objekt strategjik, pagesa e pesë anëtarëve ka ndikuar negativisht në rezultatin e periudhës. Bazuar në madhësinë e shoqërisë dhe aktivitetit të saj. Për këtë **është rekomanduar:**

- Nga Ministri i Financave, bazuar në konstatimet e këtij auditimi, të bëhet ristrukturimi i Këshillit të Administrimit, ripërcaktim të numrit të anëtarëve të tij në zbatim të akteve normative në fuqi për "Numrin e anëtarëve të këshillave mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore, që krijohen nga transformimi i ndërmarrjeve shtetërore" dhe në kushtet që kjo shoqëri ka humbur privilegjet e për rrjedhojë edhe madhësinë e përfutur nëpërmjet "statusit të shoqërisë me objekt strategjik", këshilli i administrimit të reduktohet në 3 (tre) anëtarë, trajtuar në faqen nr. 7 të raportit përfundimtar të auditimit.

Menjëherë

5. Nga auditimi rezultoi se, *menaxhimi financiar dhe sistemi i kontrollit brendshëm nuk ka funksionuar plotësisht në shoqëri*, ligji për menaxhimin financiar dhe kontrollin nuk njihet nga strukturat drejtuese të shoqërisë, ky sistem nuk ka funksionuar dhe për pasojë, drejtuesit nuk kanë bërë një vlerësim të efektivitetit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Nga shoqëria nuk është hartuar raporti vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm; nuk ka hartuar dhe miratuar planin strategjik i cili përmban objektivat strategjike, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit; nuk ka një Kod të Brendshëm Etik ose një Kod Sjellje, rregullore apo, udhëzim për zbatimin e etikës, si dhe nuk ka procedurë për të raportuar shkeljet e legjislacionit mbi etikën dhe për marrjen e masave për shkeljet e konstatuara; njësia nuk ka rregulla të brendshme të miratuara nga titullari, të cilat trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre; njësia nuk ka miratuar Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS). Gjithashtu, nuk është hartuar strategjia e riskut dhe regjistri i riskut, e për pasojë drejtuesi nuk është i vetëdijshëm për përgjegjësinë që ka në menaxhimin e riskut; nuk ka sistem monitorimi për vlerësimin e efektivitetit dhe progresit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm për arritjen e objektivave etj.

Për këtë është rekomanduar:

-Të plotësojë dhe të dërgojë në ministri, raportin vjetor mbi cilësinë dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm gjatë vitit të mëparshëm buxhetor, me qëllim që të ndihmojë në identifikimin e atyre aspekteve të kontrollit të brendshëm, ku nevojitet të ndërmerret ndërgjegjësim i mëtejshëm dhe ku duhet të adresohen nevojat për trajnim.

-Të marrë masat për të hartuar dhe miratuar në rregullore rregullat e etikës, me qëllim që i gjithë stafi të udhëhiqet nga integriteti personal dhe profesional në marrjen e vendimeve dhe kryerjen e detyrave, si dhe të hartojë një procedurë me qëllim raportimin e shkeljeve të etikës dhe marrjen e masave për shkeljet e konstatuara.

-Të marrë masat e duhura për të bërë ndryshimin e rregullores së brendshme në përshtatje me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, si dhe në përputhje me strukturën organike të shoqërisë. Me akte administrative të brendshme, të përcaktojë delegimin e kompetencave apo të detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

-Të marrë masat e duhura për të miratuar Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS), i cili ka për qëllim të diskutojë çështjet kryesore dhe mangësitë serioze me qëllim diskutimin e mëtejshëm dhe marrjen e masave. Për të rritur përgjegjshmërinë në menaxhimin e

riskut, në drejtim të

identifikimit, vlerësimit dhe monitorimit të riskut, shoqëria të marrë masat e duhura për të hartuar dhe miratuar strategjinë e riskut e cila duhet të përditësohet rregullisht, të paktën 1 herë në 3 vjet, si dhe sa herë kur mjedisi i riskut pëson ndryshime të rëndësishme, duke bërë kështu vlerësimin dhe kontrollin e risqeve që venë në rrezik arritjen e objektivave të shoqërisë.

-Të marrë masat e duhura për zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve dhe të hartojë kërkesa specifike për trajnimin e punonjësve të administratës, për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe manualin të dalë në zbatim të tij. Gjithashtu, shoqëria të hartojë një procedurë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve dhe analizën e tyre, si dhe të bëjë dhe vlerësimin e punës së punonjësve, Për të vlerësuar përshtatshmërinë e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, të merren masat për të hartuar gjurmët e auditimit, ku të përfshihen proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë që përfshijnë zbatimin e aktiviteteve, programeve dhe projekteve me të rëndësishme,

Menjëherë dhe në vazhdimësi

6. Në të gjitha kontratat e sipërmarrjes të lidhura midis Shtypshkronjës së Letrave me Vlerë sha dhe subjekteve private të lojërave të fatit nuk është zbatuar afati i parashikuar i pagesës brenda 30 ditëve kalendrike nga dita e dorëzimit të porosisë nga sipërmarrësi (shtypshkronja).

Ndërkohë konstatohet se megjithëse në disa prej kontratave janë parashikuar penalitete në rast të mos përmbushjes së detyrimeve financiare kontraktuale nga pala porositëse brenda afatit të parashikuar në kontratë, në asnjë rast këto penalitete nuk janë aplikuar,

Për këtë është rekomanduar:

- Të merren masa të menjëhershme për të standardizuar kontratat me subjektet në mënyrë që si të drejtat dhe detyrimet të jenë të mirë përcaktuara, të sigurohet trajtimi i njëjtë dhe për më tepër të mbrohen interesat e shoqërisë, Të synohet në vendosjen e penaliteteve në rast të mos përmbushjes së detyrimeve dhe veprohet për të kërkuar përfitimin e këtyre penaliteteve si një e drejtë kontraktuale, në rast se konstatohen vonesa të pajustificuara. Kjo masë gjykojmë se do të ndikojë në uljen e kërkesave ndaj subjektet ekonomike debitore dhe do të shmangi efektet negative financiare që pason një stok i lartë e kërkesave të arkëtueshme.

Menjëherë

7. Nga auditimi i prokurimeve i zhvilluar për vitin 2013 dhe 2014 u konstatua se nuk është hartuar regjistri i realizimeve për vitin 2013 dhe vitin 2014 ku të jenë të identifikuar qartë procedurat e realizuara, fondet e përdorura dhe kontratat e realizuara, kjo sipas parashikimeve të bëra nga institucioni mbi procedurat që do të kryejë për shërbime, mallra etj, kjo duke lënë shteg për realizimin e shpenzimeve dhe deklarimin e tyre jo bazuar në nevojat e përcaktuara në projekt programet e miratuara.

Për këtë është rekomanduar:

-Nga institucioni Shtypshkronja e Letrave me Vlere të merren masa të menjëhershme për hartimin e regjistrit të realizimeve të prokurimeve publike të zhvilluara sipas regjistrit të parashikimeve te kryera nga institucioni, ku të jenë të identifikuar qartë procedurat e realizuara, fondet e përdorura dhe kontratat e realizuara.

Menjëherë

8. Nga auditimi i procedurës së prokurimit "Blerje letër vetëkopjuese për shtypjen e

dokumentacionit tatimor, letër me element sigurie dhe letër për shtypjen e biletave të ndryshme" rezulton se, Titullari i Autoritetit Kontraktor nuk ka nxjerrë urdhër për miratimin dhe ngritjen e komisionit të vlerësimit të fondit limit dhe specifikimeve teknike. Nga auditimi rezulton se për blerjen e letrës vetëkopjuese për shtypjen e dokumentacionit tatimor, letrës me element sigurie dhe letrës për shtypjen e biletave të ndryshme, nga Autoriteti kontraktor nuk janë hartuar preventiva për llogaritjen e fondit limit si dhe nuk janë hartuar specifikime teknike lidhur me objektin që prokurohet, pa përmendur këtu faktin që nga analizat e stokut të letrës në momentin e realizimit të kësaj procedure.

Nisur nga konstatimi se, në tenderin e zhvilluar "Letër për shtypshkrime" me procedurë "Negociim pa botim paraprak të njoftimit të kontratës", nuk ndodhemi në kushtet e nevojës ekstreme pasi rrethanat e përmendura për të justifikuar nevojën ekstreme nuk duhen të shkaktohen në asnjë rast nga veprimi ose mosveprimi i autoritetit kontraktor. Në këtë rast mosveprimi i autoritetit kontraktor ka sjellë anulimin e "procedurës së hapur".

Për këtë është rekomanduar:

Nga Administratori të analizohet dhe dokumentohet nevoja për blerje në çdo rast dhe veçanërisht për konsumin e letrës që përbën dhe koston kryesore të aktivitetit të shoqërisë. Kjo analizë duhet të bëhet e kujdesshme që në fillim për të eliminuar procedura prokurimi që dëmtojnë konkurrencën dhe ndikojnë në ekonomikitetin e përdorimit të fondeve. Në vijimësi administratori të marra masa për ngritjen e komisioneve për çdo procedurë, të hartohen preventiva të saktë si dhe specifikime të qarta sipas objektit që prokurohet, kjo sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi "Për Prokurimet Publike", dhe të largohet nga realizimi i dokumenteve formale që plotësojnë procedurat e prokurimit.

Vazhdimisht

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Subjekti I sha rezulton debitor prej vitit 2011 me fatura të pa likuiduara në shumën totale prej 2,304,000 lekë. Megjithëse subjekti I vazhdimisht nuk ka zbatuar detyrimet kontraktuale dhe ka mbartur debi, SHLV ka vazhduar të ofrojë shërbim deri në 5.01.2013,

Për këtë është rekomanduar;

- Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit për arkëtimin e shumës 2,304,000 lekë, të shkaktuar si pasojë e mbartjes së vazhdueshme të debive të krijuara nga mos likuidimi i detyrimit financiar për kontratën e shërbimit.

Menjëherë

2. Me transaksionin e datës 25.03.2013 në BKT, është kryer shpenzimi sigurimi për një vit nga zjarri dhe rreziqe shtesë të ndërtesës, makinerive, lëndës së parë dhe lëndës ndihmëse në shumën 441,600 lekë. Titullari i Autoritetit Kontraktor ka nxjerrë urdhër prokurimin nr.9, datë 04.03.2013. Në këtë procedurë prokurimi kishin marrë pjesë pesë operatorë ekonomikë, nga vlerësimi i të cilës ka rezultuar fitues kompania A me vlerë 368,000 lekë, vlerë më e lartë se ajo e operatorit IN që është s'kualifikuar padrejtësisht duke sjellë një dëm për buxhetin në vlerën 78,000 lekë. Pra diferenca, prej 78,000 lekë përbën dëm ekonomik për të ardhurat e institucionit, si pasojë e veprimeve në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Për këtë është rekomanduar:

Shoqëria "Shtypshkronja e Letrave me Vlerë" sha të marrë masat për arkëtimin e shumës prej 78,000 lekë nga komisioni i blerjeve të vogla nga personat A.G, A.V, Y.V.

Menjëherë

C. MASA DISPLINORE+

C.1 Në mbështetje të nenit 135 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i është rekomanduar Ministrit të Financave, në cilësinë e "Asamblesë së Përgjithshme" dhënien e masës disiplinore "*Lirim nga Detyra*" për z. N.T me detyrë Administrator, pasi gjatë ushtrimit të detyrës ka keqadministruar fondet në dispozicion të kësaj shoqërie dhe nuk ka marrë masa për ushtrimin e kontrollit në veprimtarinë ekonomiko-financiare, ka krijuar hapësira për siguri jo të mjaftueshme mbi dokumente të cilat duhet të trajtohen si letra me vlerë nga pikëpamja e administrimit pavarësisht kostos së realizimit të tyre.

Ka lejuar copëzimin e fondeve, pasi gjate vitit 2014 ka zhvilluar dy procedura prokurimi me objekt blerje letër për shtypshkrime dhe me procedurë "Negocim pa botim paraprak të njoftimit të kontratës" në kundërshtim me nenin 1 të ligjit nr. 9463, datë 20.01.2006, i ndryshuar, veprim i cili ka sjellë si pasojë kufizimin e pjesëmarrjes të një numri më të madh të operatorëve ekonomikë, duke ulur në këtë mënyrë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë,

Ka lejuar kryerjen e procedurave të prokurimit për blerje letër për shtypshkrime në vlerën prej 38 milionë lekë, ndërkohë që në magazinën e shoqërisë në datën kishte gjendje të konsiderueshme në vlerën prej 48,254 mijë lekë, e mjaftueshme për realizimin e kontratave për gjithë vitin 2014, veprim i cili ngurtëson mjetet financiare, rrit gjendjen e mallrave stok, si dhe shton mundësinë e dëmtimit të lëndës së parë.

Nga auditimi u konstatua se Tenderi me objekt "Blerje letër për shtypshkrime" zhvilluar me urdhrin e prokurimit 370/5, datë 22.09.2014 është kryer me procedurë "negocim pa botim paraprak të kontratës" me arsyetimin e "ndodhjes në kushtet e nevojës ekstreme për nevoja emergjente", duke shmangur në këtë mënyrë konkurrencën, veprim i cili është në kundërshtim me procedurat e prokurimit publik.

Nuk ka marrë masa për arkëtimin e detyrimeve sipas dispozitave ligjore duke lejuar që subjekti "Interbast" të zhvillojë aktivitet privat me mjetet financiare të shoqërisë, pasi për një periudhë disa vjeçare nuk ka likuiduar ndaj shoqërisë vlerën prej 2,304 mijë lekë.

Nuk ka marrë masa për hartimin dhe dërgimin në APP të regjistrit të ndryshimeve gjatë vitit dhe të realizimit të prokurimeve publike për vitin 2014 për blerjet me vlera të vogla, në kundërshtim me VKM nr 1, datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" kreu 1, pika 3, germa d "Raportimi i realizimeve të prokurimit publik" dhe germa "dh" Regjistri kombëtar i realizimit të prokurimeve publike.

Nga auditimi mbi hartimin e miratimin e projektprogramit të zhvillimit ekonomik për vitin 2014 konstatohet se, këto projektprograme shpenzimesh për vitin 2014 nuk janë hartuar dhe mbështetur në tregues reale, por janë plotësuar në mënyrë formale. Gjithashtu u konstatua se nga administratori nuk është marrë në analizë tremujore realizimi i treguesve ekonomikë të shoqërisë, kjo për të parandaluar risqet dhe rishikuar treguesit të cilët nuk ishin marre në konsideratë në kohën e programimit të treguesve.

2. F.P, me detyrë "Përgjegjëse e sektorit të prodhimit", pasi nuk ka marrë masa të plota për përcaktimin e saktë të sasisë së lëndës së parë në kartat teknologjike për çdo prodhim të shtypshkrimeve, duke lejuar në këtë mënyrë tejkalim të lëndës së parë për njësi

prodhimi, pasi vetëm për artikullin "bloqe-faturo tatimore me TVSH u konstatua një humbje e konsiderueshme e lëndës së parë e cila llogaritet në masën 10 %.

D. TË TJERA

I kërkohet **Ministrit të Financave** të analizojë konstatimet e këtij auditimi dhe të shprehet si për Këshillin e Administrimit dhe për domosdoshmërinë e inicimit të një inspektimi të plotë financiar lidhur me nivelin e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë nga mosdokumentimi dhe mos vlerësimi i elementëve të kostos së produkteve të realizuara apo dhe monitorimi i konsumit të letrës si elementi më kryesor i kostos së produktit Vetëm nga analiza e një produkti të bërë nga grupi i auditimit konstatohet një konsum i pajustificuar i materialit letër në nivelin 10% të totalit të partisë së produktit.

E. KALLËZIM PENAL

Bazuar në gjetjet e auditimit të ushtruar në Shtypshkronjën e Letrave me Vlerë sha, kallëzohet në organet e Prokurorisë N.T., në cilësinë e administratorit të shoqërisë; për shpërdorim detyrë, parashikuar në Nenin 248 të Kodit Penal.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Alkida Llakaj përgjegjëse grupi, Dritan Kore dhe Eriola Meçaj, më tej materiali u shqyrtua nga Kryeaudituesi, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Zbatimit të Standardeve, si dhe nga Drejtori i Departamentit.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT